

Në bazë të nenit 12 paragrafit 5 të Ligjit mbi financimin e subjekteve politike dhe kampanjave zgjedhore ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 76/15, 083/16 dhe 092/17), Vendimit mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2019, (Fleta Zyrtare e Malit të Zi –dispozitat komunale" 29/19), Vendimit të kryetarit nr. 01-031/19- 5578 prej më 17.09.2019 U.D. së Sekretarit të Sekretariatit për financa dhe zhvillim ekonomik i Komunës së Tuzit, sjellë:

V E N D I M

mbi lartësinë e mjeteve buxhetore të destinuara për financimin e punës së rregullt të subjekteve politike për periudhën 01.08 – 31.12.2019

Neni 1

Mjetet Buxhetore për financimin e rregullt të punës së subjekteve politike në Komunën e Tuzit, janë 1,1% e totalit të mjeteve të planifikuara Buxhetore, të zvogëluara për mjetet e buxhetit kapita (buxheti rrjedhës), për vitin për të cilin sjellët buxheti komunës.

Jashtëzakonisht, për komunat të cilat buxheti i tyre është më i vogël se pesë milion euro, mjetet buxhetore për financimin e punës së rregullt të subjekteve politike në kuvendin e komunës janë nga 1,1% deri në 3% e totalit të mjeteve të planifikuara buxhetore, të zvogëluara për mjetet e buxhetit kapital (buxheti rrjedhës), për vitin për të cilin sjellët buxheti.

Me Buxhet të Komunës së Tuzit për vitin 2019 për financimin e rregullt të punës së subjekteve politike janë paraparë mjetet në shumën prej 12.117,70 euro, gjegjësisht 2.4% e mjeteve të Buxhetit total të planifikuar të zvogëluara për mjetet e buxhetit kapital për periudhën 01.08-31.12 2019

Mjetet në shumën nga 20% shpërndahen në mënyrë të barabartë të subjekteve politike në Kuvend, ndërsa 80% e mjeteve tjera proporcionalisht numrit të mandateve të këshilltarëve që kanë në momentin e ndarjes.

Neni 2

Mjetet e parapara nga neni 1 do tu shpërndahen subjekteve politike të cilat kanë këshilltarë në Kuvendin e Komunës së Tuzit, në shumën në vijim:

Partia Demokratike Socialiste 3.375,72

Alternativa Shqiptare 3.072,77

Partia Boshnjake 1.558,02

Lidhja Demokratike Shqiptare 1.558,02

Unioni Demokratik i Shqiptarëve 1.255,07

Socialdemokratët 649,05

Mali i Zi Demokratik 649,05

Neni 3

Mjetet nga neni 2 u përcjellën subjekteve politike për muaj, deri me datën 5 të muajit për muajin e kaluar, përveç për muajin gusht dhe shtatorë, për të cilat mjetet do të përcjellën në afat të arsyeshëm.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi me sjelljen e tij, e do të zbatohet për periudhën nga 01.08-31.12.2019

Numër: 05-032/19-5625

Tuz, 18.09.2019

U.D.SEKRETAR
mr. Emin Haxhi

